

**Marrëveshje Për Bashkëpunimin Shkencor
Ndërmjet
Këshillit Kombëtar të Kërkimit të Italisë
Dhe
Ministrisë Së Arsimit Dhe Sportit Të Republikës Së Shqipërisë**

Në bazë të "Marrëveshjes për bashkëpunimin kulturor ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë", nënshkruar në Tiranë më 12 shtator të vitit 1994, të "Marrëveshjes për bashkëpunim shkencor dhe teknologjik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë", nënshkruar në Tiranë më 18.12.1997, Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë (MAS) dhe, Këshilli Kombëtar i Kërkimit të Italisë (CNR), (referuar në vijim si Palë), kanë rënë dakord si më poshtë:

**Neni I
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të forcojë më tej bashkëpunimin në kërkimin dhe zhvillimin ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. Palët, bazuar në principet e barazisë dhe përfitimit reciprok, do të promovojnë dhe mbështesin bashkëpunimin ndërmjet studiuesve të tyre dhe fushave të kërkimit më me interes për të dyja palët. CNR do të mbështesë MAS dhe Institucionet e Arsimit të Lartë shqiptare (IAL-të) për zbatimin e reformës në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

**Neni II
Format e bashkëpunimit dhe të zbatimit**

Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, bashkëpunimi mund të përfshijë aktivitetet e mëposhtëm:

- a) Projekte të përbashkëta kërkimore;
- b) Seminare të përbashkët;
- c) Aktivitete të përbashkëta për zbatimin e reformës në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe të strategjisë për kërkimin shkencor;
- d) Veprimtari të tjera të bashkëpunimit për të cilat mund të jetë rënë dakord bashkërisht.

Projektet e ndërmarra në bazë të kësaj Marrëveshjeje mund të orientohen për pjesëmarrje të mëtejshme në programin "Horizon 2020" dhe programe të tjera evropiane.

Detajet dhe Programi i Bashkëpunimit për çdo formë bashkëpunimi do të vendosen nga palët. Palët do të rishikojnë Programin e Bashkëpunimit të paktën çdo dy vjet. Në varësi të llojit të aktiviteteve, ai duhet të përmbajë, ndër të tjera edhe dispozitat në vijim:



- Titullin, përshkrimin, kohëzgjatjen dhe specifikimet financiare për projekte të përbashkëta kërkimore, seminarët apo çdo nisëm tjetër të përzgjedhur nga palët, si dhe emrat e shkencëtarëve, stafit dhe akademikëve pjesëmarrës, vetëm kur Komiteti i Përbashkët ka vendosur të financojë për këto projekte të përbashkëta.

Neni III Praktika

- Secila palë do të mbulojë shpenzimet e kërkuesve pjesëmarrës nga vendi i tij. Numri i projekteve, seminarëve dhe çdo aktiviteti tjetër bashkëpunimi që do të mbështeten çdo vit, do të jenë të kushtëzuara nga mundësitë financiare të pasqyruara në buxhetin e secilës palë, i cili do të përcaktohet çdo 2 vjet me rinovimin e Programit të Bashkëpunimit.
- Lidhur me shkëmbimin e informacionit, përvojës dhe të ekspertëve që synojnë të merren me përgatitjen e akteve nënligjore që rrjedhin nga "Ligji shqiptar për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe zbatimit të Reformës në Arsimin e Lartë dhe Shkencën në Shqipëri, si dhe të Strategjisë për Kërkimin Shkencor, shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje në vendin pritës, shpenzimet për akomodim dhe qendrim të ekspertëve që do të shkëmbehen, do të mbulohen nga MAS me kontributet e palëve të treta. Numri i ekspertëve dhe afatet kohore të shkëmbimeve do të dakortësohen përmes korrespondencës midis palëve.

Neni IV Zbatimi i ligjshmërisë

Studiuesit pjesëmarrës zbatojnë kuadrin ligjor të vendit pritës dhe rregulloret e institucioneve pritëse.

Neni V Pronësia intelektuale

Për sa i përket projekteve dypalëshe të kërkimit shkencor, të drejtat për pronësinë intelektuale do t'i takojnë kërkuesit dhe/ose organizatave të Kërkimit dhe Zhvillimit që kanë punësuar kërkuesit. Në çdo publikim që vjen si rezultat i një kërkimi shkencor duhet të përmendet mbështetja e marrë nga Palët.

Neni VI Çështje të tjera

Procedurat administrative dhe detajet e zbatimit që nuk janë përcaktuar në këtë Marrëveshje do të trajtohen më vete në Programin e Bashkëpunimit ose do të bihet dakord përmes shkëmbimit të korrespondencës.




Neni VII
Vlefshmëria, Amendimet, Përfundimi

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy palët dhe do të vazhdojë për katër vjet. Secila palë mund të njoftojë me shkrim palën tjetër nëse ka ndërmend të ndërpresë atë përmes njoftimit përmes rrugëve diplomatike, dhe në këtë rast, çdo program ekzistues do të çohet drejt përfundimit të rregullt të tij. Njoftimi duhet të bëhet 6-të muaj përpara përfundimit të Marrëveshjes. Marrëveshja mund të zgjatet për të njëjtën periudhë të vlefshmërisë prej katër vitesh në mungesë të njoftimit të ndërprerjes nga secila palë.

Kjo marrëveshje është bërë në tre kopje origjinale, në gjuhët italisht, shqip dhe anglisht, të gjitha tekstet janë të barasvlershme. Në rast kontestimesh mbi interpretimin e tekstit do të mbizotërojnë versioni anglisht.

Nënshkruar në _____, më _____

Për
Këshillin Kombëtar të Kërkimit
të Italisë



Presidenti
Massimo Inguscio

Për
Ministrinë e Arsimit Sportit të Republikës
së Shqipërisë



Ministri
Lindita Nikolla

m. 5283
01/18.5.2014